



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

### GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.6/2024

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit M.K, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga H.B, nga P., me banim në rrugën “H. R.” nr..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga H.B, nga Peja, me banim në rrugën “H. R.” nr..., ndaj gjyqtarit M.K, **SI E PABAZUAR.**

#### A r s y e t i m

Me datë 23.05.2024, H.B, nga Peja, me banim në rrugën “H. R.” nr..., ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit M.K, me arsyetimin se me datë 18.03.2024 ka kërkuar me shkrim anulimin e seancës së datës 14.05.224, mirëpo gjyqtari nuk i është përgjigje fare, ndërsa i njëjti vëllain e tij në Austri e ka thirrë dy herë në telefon për seancën e datës 14.05.2024 por, nuk e din se si gjyqtari ka arritur deri te numri i tij i telefonit dhe vëllai i tij ka ardh dhe ka marrë pjesë në seancë pa dijeninë e këtu parashtruesit të ankesës. Po ashtu, ankuesi ka theksuar se ka kërkuar nga vëllai i tij që t’ia tregoj apo t’ia jap për ta fotokopjuar Procesverbalin e seancës mirëpo, ai ka kundërshtuar çka do të thotë se gjyqtari në fjalë i ka thënë vëllait të ankuesit se e ka të ndaluar t’ia tregoj dikujt Procesverbalin e seancës andaj, i njëjti e ndien se kjo seancë është organizuar qëllimisht në dëmin familjar dhe këtu vie pyetja se çfarë interesi paska gjyqtari M.K nga kjo pronë familjare të cilën e posedojnë qe më shumë se dyzetedy (42) vite dhe se ky gjyqtar i ri është i dyshuar si bashkëpunues i fajdeve me disa avokatë. Përfundimisht, i njëjti ka shtuar se vëllai i tij e ka kërcënuar me vdekje nëse nuk nënshkruhet në seancën e ardhshme që do të thotë se i njëjti paska vështirësi të madhe për kthimin e borxhit me fajde.

Me datë 23.05.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga H.B ndaj gjyqtarit M.K.

Gjyqtari M.K në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se në këtë Gjykatë është në procedim e sipër çështja civile e paditësve H.B etj. kundër të paditurve D. H. – M etj. me bazë juridike vërtetim i pronësisë me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Fillimisht, gjykata me datë 04.05.2022 e ka refuzuar propozimin e paditësve për caktim të masës së përkohshme e pastaj, sipas radhës dhe numrit të lëndës, gjykata aktvendimin për përgjigje në padi ju ka dërguar të paditurve, ku të paditurit e kanë dhënë përgjigjen në padi dhe gjykata me datë 14.05.2024 ka caktuar seancën përgatitore, për të cilën seancë me ftesa i ka ftuar paditësit dhe të paditurit mirëpo, në seancë ka prezantuar paditësi R.B ndërsa paditësit e tjerë nuk kanë prezantuar dhe se në këtë seancë paditësi R.B e ka njoftuar gjykatën se paditësit e tjerë i ka vëllezër dhe motra dhe të njëjtit jetojnë në mërgim dhe se do të sigurojë autorizimin për përfaqësim. Lidhur me ankesën disiplinore, gjyqtari ka theksuar se e njëjta nuk qëndron me arsyetimin se nga vetë përmbajtja e njëjta është e paargumentuar dhe janë shpifje duke cenuar rëndë dinjitetin e tij si gjyqtar dhe se në

seancë nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e gjykatës me të cilin paditësi të jetë dëmtuar në raport me pronën e tij andaj, vlerëson se kjo ankesë nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e as në Kodin e Etikës.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit M.K, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore dhe gjeti se pretendimet në fjalë janë të paargumentuara me asnjë provë dhe shumë të përgjithësuara. Pretendimi se gjyqtari nuk i është përgjigje kërkesës së ankuesit për shtyrje të seancës dhe se vëllain e tij e ka thirrë përmes telefonit për të marrë pjesë në seancë, në mungesë të rrethanave të tjera që do t'a bindnin autoritetin kompetent ndryshe, nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë. Ndërsa, pretendimet e ankuesit se gjyqtari ia ka ndaluar vëllait të tij që t'ia jap Procesverbalin e seancës gjyqësore të tjerëve për ta shikuar ose kopjuar apo se gjyqtari e ka organizuar seancën gjyqësore qëllimisht në dëm të familjes së këtu ankuesit, nuk janë mbështetë me asnjë provë dhe nuk janë argumentuar në asnjë mënyrë nga ana e parashtruesit të ankesës ashtu si edhe pretendimi se gjyqtari M.K së bashku me disa avokatë është i dyshuar për fajde, e i cilin pretendim i parashtruesit të ankesës duke mos qenë i argumentuar mbetet vetëm një supozim i palës ankuese, në të kundërtën i njëjti ftohet që në rast se posedon prova që i mbështesin dyshimet e tilla të njoftojë autoritet kompetente për zhvillim të hetimeve të mëtejme. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.6/24, me datë 29.05.2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit M.K*
- 3. Parashtruesit të ankesës – H.B, rruga “H. R.” nr., Pejë*